

"Prag"

Pjesa social-teatrale "**Prag**" u shfaq me sukses në disa njësi vendore të vendit, në komunën Bërzhitë, Tiranë, në Bashkinë Manzë, në Komunën Prezë, Tiranë dhe në Komunën Kashar, Tiranë.

"Prag" është pjesë sociale e dramatizuar, kushtuar sfidës së grave të dhunuara shqiptare, në kërkim të identitetit të tyre, me ndihmën e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare. Ajo performohet nga avokatët dhe studentët e skuadrave *pro bono* pranë kësaj Qendre.

Morën pjesë rreth 179 të ftuar (banorë pjesëtarë të komunitetit, nxënës, mësues, prindër dhe përfaqësues të institucioneve vendore), të cilët ndoqën me interes shfaqjen. Në përfundim të saj, zhvilluan diskutime mbi çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe mbi masat që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse për parandalimin e saj.

Aktivitetet u organizuan nga **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare** në kuadrin e zbatimit të projektit ***"Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit mbi dhunën në familje përmes dramatizimit"***, i cili mbështetet nga **Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë, partner në projekt.**

Në vijim, foto nga aktivitetet.

Foto nga aktiviteti i organizuar në Bërzhitë në datën 19.01.2015



Foto nga aktiviteti i organizuar në Prezë në datën 06.02.2015



Foto nga aktiviteti i organizuar në **Manzë**, në datën 26.01.2015



Foto nga aktiviteti i organizuar në **Kashar**, në datën 16.02.2015

